



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË**

Nr. 5411/prot.
1

Tiranë, më 19.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1674, datë 06.09.2013.

SHOQËRISË “VIKTORIA INVEST INTERNATIONAL” SH.P.K

**Lagjia “28 Nëntori”, Rruga “11 Nëntori”,
Pranë Tatim-Taksave, Kati i Dytë, Elbasan**

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “Viktoria Invest International” shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1674, datë 06.09.2013, për mineralin ndërtimor ultrabazike, në objektin “Bratille” Gramsh, Qarku Elbasan.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.5831, datë 27.07.2017 (prot. MEI nr. 5411, datë 01.08.2017), ka propozuar revokimin e lejes nr.1674, datë 06.09.2013, për mineralin ndërtimor ultrabazik, në objektin “Bratille” Gramsh, Qarku Elbasan, për arsye se subjekti “Viktoria Invest International”, që nga momenti i marrjes së lejes nuk ka filluar punë, megjithëse kane kaluar rreth 4 vite nga data kur është marrë kjo leje.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në paragrafin “ii”, të germës “b”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr. 1674, datë 06.09.2013, për mineralin ndërtimor ultrabazik, në objektin “Bratille” Gramsh, Qarku Elbasan.**

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1674, datë 06.09.2013, për mineralin ndërtimor ultrabazik, në objektin "Bratilë" Gramsh, Qarku Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

